



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.19, datë 06.11.2018


PËR

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT “SPATHARA”, BASHKIA LIBRAZH, QARKU
ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë koncesionare “Luçente Koncesionare” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i hidrocentralit “Spathara”, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 10.05.2013, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “Luçente Koncesionare” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 10.05.2013 nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

